



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr.89

Datë 16 qershor 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 51/2014 datë 15.5.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	3591
Udhëzim i MTI nr. 5, datë 30.5.2014	Për një shtesë në udhëzimin nr. 10, datë 23.6.2008, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, të ndryshuar.....	3591
Urdhër i MBZHRAU nr. 286, datë 2.6.2014	Mbi një ndryshim në urdhrin nr. 438, datë 7.10.2008, “Për miratimin e rregullores, “Mbi kushtet e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, të certifikatave të qumështit lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human””	3592
Kërkesë e MTI nr. 3042, datë 9.6.2014	Për shpronësim, publik për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë (Dritat e verdha–Kryqëzimi, rruga Korçë-Kapshticë), shtesat”.....	3593

LIGJ
Nr. 51/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
LIGJIN NR. 9741, DATË 21.5.2007, “PËR
ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimet “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” dhe “Ministri i Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “ministra përgjegjëse për çështjet e arsimit” dhe “ministri përgjegjës për çështjet e arsimit”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“5. Në institucionet e arsimit të lartë publik, që kanë qendra spitalore universitare, departamentet përbëhen edhe nga shërbimet, të cilat formohen në bazë të specialitetit. Shërbimi realizon funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e spitalit universitar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.”

6. Në institucionet e arsimit të lartë, që kanë qendra spitalore universitare, përgjegjësi i shërbimit është titullari i shërbimit. Kriteret e përzgjedhjes së përgjegjës të shërbimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.”.

2. Në pikën 6.2, paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 12/1 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“1. Qendrat spitalore universitare janë njësi të sistemit arsimor dhe të sistemit shëndetësor. Ato realizojnë funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e sistemit shëndetësor, dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë.”

4. Veprimtaria e qendrës spitalore universitare rregullohet me statutin e saj, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.”.

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.5.2014

Shpallur me dekretin nr. 8590, datë 5.6.2014 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 5, datë 30.5.2014

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË
23.6.2008 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E
LËSHIMIT, PEZULLIMIT DHE HEQJES SË LEJEVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE LEJEVE
TË OPERIMIT NË FUSHAT E TRANSPORTIT
DETAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 9 dhe 401, pika “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 15.5.2013, “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009”,

UDHËZOJ:

Ndryshimin e udhëzimit nr. 10, datë 23.6.2008, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, të ndryshuar, si më poshtë:

1. Në nenin 10 “Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonën portuale të Durrësit dhe në radën përkatëse”, në pikat 3 dhe 4, pas fjalës “...e pronësisë” të shtohen fjalët “ose kontratën e qiramarrjes...”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

URDHËR
Nr. 286, datë 2.6.2014

MBI NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 438, DATË 7.10.2008, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KUSHTET E SHËNDETIT PUBLIK DHE SHËNDETIT TË KAFSHËVE, TË CERTIFIKATAVE TË QUMËSHTIT LËNDË E PARË DHE TË PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI PËR KONSUM HUMAN””

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, nenit 76 të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian dhe shteteve të tyre anëtare”, pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 5.7.2006, “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 438, datë 7.10.2008, “Për miratimin e rregullores “Mbi kushtet e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, të certifikatave të qumështit lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human”, aneksi 1 zëvendësohet me shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**
Edmond Panariti

SHTOJCË

LISTA E VENDEVE TË LEJUARA PËR FUTJEN E NGARKESAVE ME QUMËSHT LËNDË E PARË DHE PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Vendet e lejuara për futjen e ngarkesave me qumësht lëndë e parë dhe produkteve me bazë qumështi në Republikën e Shqipërisë, janë:

1. Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Vendet e treta ose pjesë të autorizuara të tyre sipas tabelës më poshtë.

Shenjat ‘+’ dhe ‘0’ kanë kuptimin e mëposhtëm:

‘+’: Vendi i tretë i cili është i autorizuar.

‘0’: Vendi i tretë i cili nuk është i autorizuar.

Kodi ISO i vendit të tretë	Vendi i tretë ose pjesë të tij	Kolona A	Kolona B	Kolona C
AD	Andorra	+	+	+
AE	Emirati i Dubait i Emirateve të Bashkuara Arabe ⁽¹⁾	0	0	+ ⁽²⁾
AR	Argjentina	0	0	+
AU	Australia	+	+	+
BR	Brazil	0	0	+
BW	Botsvana	0	0	+
BY	Belarus	0	0	+
BZ	Belize	0	0	+
BA	Bosnjë-Hercegovina	0	0	+
CA	Kanada	+	+	+
CH	Zvicër	+	+	+
CL	Kili	0	+	+
CN	Kina	0	0	+
CO	Kolumbia	0	0	+
CR	Kosta Rika	0	0	+
CU	Kuba	0	0	+
DZ	Algjeria	0	0	+
ET	Etiopia	0	0	+
GL	Grenlandë	0	+	+
GT	Guatemala	0	0	+
HK	Hong Kong	0	0	+
HN	Honduras	0	0	+

IL	Izrael	0	0	+
IN	India	0	0	+
IS	Islandë	+	+	+
KE	Kenia	0	0	+
MA	Marok	0	0	+
MG	Madagaskar	0	0	+
MK	Maqedonia	0	+	+
MR	Mauritania	0	0	+
MX	Meksika	0	0	+
NA	Namibia	0	0	+
NI	Nikaragua	0	0	+
NZ	Zelanda e Re	+	+	+
PA	Panama	0	0	+
PY	Paraguai	0	0	+
RS	Serbia	0	+	+
RU	Rusia	0	0	+
SG	Singapor	0	0	+
SV	El Salvador	0	0	+
SZ	Svaziland	0	0	+
TH	Tailand	0	0	+
TN	Tunizia	0	0	+
TR	Turqi	0	0	+
UA	Ukrainë	0	0	+
US	Shtetet e Bashkuara	+	+	+
UY	Uruguai	0	0	+
ZA	Afrika e Jugut	0	0	+
ZW	Zimbabve	0	0	+
KS	Kosova	0	+	+

⁽¹⁾ Vetëm për produktet e qumështit të prodhuara nga qumështi i deveve të llojeve *Camelus dromedarius*.

⁽²⁾ Janë të autorizuar produktet e qumështit të prodhuara nga qumështi i deveve të specieve *Camelus dromedarius*.

KËRKESË
Nr. 3042, datë 9.6.2014
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë (Dritat e verdha –Kryqëzimi, rruga Korçë-Kapshticë), shtesat”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 7 936 305.40 (shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesë pikë dyzet) lekë.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NE SEGMENTIN RRUGOR
"UNAZA VERIORE KORÇE" (DRITAT E VERDHA-KRYQ. RRUGA KORÇE-KAPSHITICE) SHITESAT

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurise	Sip. Totale	Siperfaqja (m2)	TOKE TRUALI		TOKE ARE		Vlera Totale (leke)	Shenime
								Çmimi (leke/m2)	Vlera (leke)	Çmimi (leke/m2)	Vlera (leke)		
1	Klea		Sevo +bp.	8561	1/751	2700	350	10000	3500000			3500000	Konfirmim ZVRPP
2	Mishel		Stefanllari + bp.	8562	6/64	117.2	23	10000	230000			230000	Konfirmim ZVRPP
3	Luan	Shefqet	Banaj	8562	6/190	74.5	22	10000	220000			220000	Konfirmim ZVRPP
4	Fiqirije		Gjata + bp.	8562	6/469	280	53	10000	530000			530000	Konfirmim ZVRPP
5	Fiqirije		Gjata + bp.	8562	6/334	16.5	16.5	10000	165000			165000	Konfirmim ZVRPP
6	Spiro	Fane	Gjoni	1101	204/22	1760	75			279.4	20955	20955	Konfirmim ZVRPP
7	Klea	Vasillaq	Spiro	8561	11/82	1163	86	10000	860000			860000	Konfirmim ZVRPP
8	Ilia	Ligor	Tili + bp.	8561	11/110	29760	235	10000	2350000			2350000	Konfirmim ZVRPP
9	I Paidentifikuar			1101	261/5		83			279.4	23190.2	23190.2	Konfirmim ZVRPP
10	Sali	Tefik	Ravolli	1101	218/10	8300	133			279.4	37160.2	37160.2	Konfirmim ZVRPP
							1076.5		785000		81305	7936305.40	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006